QKLL 2025

TETOR

AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

ALDA BARDHYLI – DREJTORE E QKLL

PËRGATITI: DR. ANILA VOGLI MAKRI

21 TETOR 2025 / INSTITUTI ITALIAN I KULTURËS NË KUADËR TË JAVËS SË 25-TË TË GJUHËS ITALIANE NË BOTË SHPALL FITUESIT E ÇMIMIT "PASHKO GJEÇI" PËR PËRKTHIMIN LETRAR ITALIAN

9 TETOR 2025 / AKTIVITET ME RASTIN E 100-VJETORIT TË LINDJES SË AUTORIT TË SHQUAR, MARTIN CAMAJ

8-10 TETOR 2025 / EDICIONI I NJËMBËDHJETË I FESTIVALIT NDËRKOMBËTAR TË TË RINJVE, "TIRANA GATE" 2025

23 TETOR 2025 / NË PËRKUJTIM TË VEPRËS SË FISHTËS

20 TETOR 2025 / NË NJË TAKIM ME SHKRIMTAREN E NJOHUR SERBE MAŠA SENIČIĆ

13 TETOR 2025 / "DRITËRO AGOLLI DHE UNIVERSALITETI NË VEPRËN E TIJ"

18 TETOR 2025 / NË NJË BISEDË ME PËRKTHYESIT PRIMO SHLLAKU DHE KLODETA DIBRA

15 TETOR 2025 / TAKIM ME SHKRIMTAREN FLUTURA AÇKA

18 tetor 2025 / TAKIM ME AUTORIN ODISE KOTE

21 TETOR 2025 / INSTITUTI ITALIAN I KULTURËS NË KUADËR TË JAVËS SË 25-TË TË GJUHËS ITALIANE NË BOTË SHPALL FITUESIT E ÇMIMIT "PASHKO GJEÇI" PËR PËRKTHIMIN LETRAR ITALIAN

Istituto Italiano di Cultura a Tirana
Instituti Italian i Kulturës, bën njoftimin:
Kemi kënaqësinë të shpallim fituesit e edicionit të parë të Çmimit "Pashko Gjeçi" për Përkthimin Letrar Italian.

Fituesit janë **Alfred Bushi**, për përkthimin e *Quaderni del carcere* (29-35) të Antonio Gramsci, dhe **Diana Kastrati**, për përkthimin e *Le ambizioni sbagliate* të Alberto Moravia.

8-10 TETOR 2025 / EDICIONI I NJËMBËDHJETË I FESTIVALIT NDËRKOMBËTAR TË TË RINJVE, "TIRANA GATE" 2025

Instituti i Librit dhe i Promocionit, organizoi edicionin e njëmbëdhjetë të Festivalit Ndërkombëtar të të Rinjve, "Tirana Gate" 2025.
Aktiviteti u zhvillua në mjediset e Liceut Artistik "Jordan Misja", duke bërë bashkë shkrimtarë nga vende të ndryshme të rajonit.
Përgjatë tri ditëve, letërsia rajonale foli përmes emrave më përfaqësues të saj.

Pas fjalëve hyrëse të drejtueseve të festivalit, Irena Toçi dhe Milena Selimi, festivali vijoi me performancën e studentëve të Liceut Artistik "Jordan Misja".
Përmes paneleve të ndryshme, në datat 8, 9 dhe 10 tetor u diskutua për librin, si e vetmja vlerë universale, e cila përsos njerëzimin.

9 TETOR 2025 / AKTIVITET ME RASTIN E 100-VJETORIT TË LINDJES SË AUTORIT TË SHQUAR, MARTIN CAMAJ

Asnjë provë bashkëpunimi në dosjen e Martin Camajt

"Gjuha e arratisur ka më shumë jetë se ajo që mbahet rob nën atë flamur."- i shkruan Camaj, Arshi Pipës teksa zezoma e Sigurimit tirrte gracka për të në Tiranën Staliniste.

Për të nderuar Martin Camajn, në 100-vjetorin e lindjes së tij, në Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit albanologet Enkeleda Kapia dhe Belfiore Qose, studiuesit Behar Gjoka, shkrimtari Namik Dokle folën gjatë për cilësitë e tij si albanolog, gjuhëtar, njeri i mendimit dhe i letërsisë shqipe, me një stil te jashtëzakonshëm

Përmes Altin Hoxhës, anëtar i Autoritetit dhe Selami Zalli, Drejtor i Informacionit në AIDSSH folën edhe për fatin e tij si intelektual e qytetar, që u shënjua me vendosjen e regjimit komunist, arratisjen pas presioneve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe shpalljen "armik" për regjimin.

"Koha ku ai jetoi dhe krijoi, ashtu siç ishte fati i gjithë intelektualëve shqiptarë të diasporës – të refuzuar, të arratisur për shkak të dhunës nga vendi – shënoi edhe mungesën e tij të gjatë në diskursin shqiptar të komunikimit mbi trashëgiminë e tij", – tha Alda Bardhyli, Drejtore e QKLL-së.

Camaj: Tirana është kthyer në një laborator të gjuhës së komanduar.

Ndërsa Enkeleida Kapia, Shefe e Katedrës së Albanologjisë në Institutin e Gjuhësisë, na rrëfeu përmes letërkëmbimit që Camaj kishte me Arshi Pipën, perceptimin e tij mbi Tiranën e asaj kohe, ku nuk mungonte shprehja e dashurisë për atdheun, gjuhën shqipe dhe dhimbja se Tirana ishte kthyer në një laborator të gjuhës së komanduar – një vatër e cenuar nga mungesa e lirisë, me një hapësirë shkencore e kulturore të ndikuar nga politika, që frymëzohej drejtpërdrejt nga Stalini. Por në vlerësimet e Camajt, Eqrem Çabejn, ishte i vetmi gjuhëtar që ruante pastërtinë e gjuhës dhe nuk ndikohej nga politika zyrtare.

"Tirana është kthyer në një vend ku gjuha ka pushuar së qeni mjet komunikimi dhe është bërë mjet bindjeje."

Hetimi administrativ: Camaj i qëndroi çdo tentative të Sigurimit për manipulim dhe bashkëpunim

Ndërsa ai krijonte dhe punonte për gjuhën shqipe dhe letërsinë në Itali, Mynih dhe SHBA, në Shqipërinë komuniste Sigurimi i Shtetit e survejonte dhe krijonte dokumente për të – ashtu si për bashkudhëtarët dhe bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë në emigracionin politik, figura të anatemuara nga historiografia komuniste si Ernest Koliqi dhe Arshi Pipa.

Rreth kësaj, anëtari i Autoritetit, Altin Hoxha, foli mbi disa dimensione të përndjekjes së tij nga Sigurimi i Shtetit, si dhe tentativat për të errësuar figurën e tij përmes kërcënimeve me jetë dhe kombinacioneve te dështuara për ta rekrutuar.

Në përfundim të hetimit administrativ të Autoritetit mbi dosjen e Camajt, Altin Hoxha tha se Camaj jo vetëm që nuk bashkëpunoi me Sigurimin e Shtetit, por nuk ekziston asnjë dokument raportimi apo version që dëmton figurën e tij. Ai i qëndroi çdo tentative të Sigurimit për manipulim dhe bashkëpunim.

Po kështu, Selami Zalli, Drejtor i Informacionit në një studim të pavarur që i bëri dokumenteve arkivore, përmes analizës përcolli tezën se dokumentet që tentojnë të hedhin hije mbi Camajn janë të manipuluara me qëllim zbehjen e ndikimit të tij akademik si albanolog dhe shkrimtar në forumet e larta akademike, jo vetëm në Europë, por edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

"Kushdo që përpiqet të flasë për dosjen Camaj është i neveritshëm."

Ndërsa shkrimtari dhe ish-kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Namik Dokle, tha:
"E vërteta është e mirë për të gjithë ta dëgjojmë, por kush flet për dosjen Camaj është i neveritshëm. Martin Camaj është shkrimtar, gjuhëtar, patriot. Në mentalitetin e vjetër ai quhet tradhtar, por si shumë të tjerë, ai e ka lënë atdheun me dhimbje, sepse e dinte që po të rrinte, jeta e tij do të rrezikohej, presioni do të shtohej dhe do të humbiste dinjitetin e tij.
Kushdo që përpiqet të flasë për dosjen Camaj është i neveritshëm. Ata kanë iluzionin se po të hedhin gurë mbi një pemë, bëhen pemë, por jo – ata mbeten gurë, ndërsa Camaj mbetet një Pemë."
Ai nuk u kthye fizikisht më në atdhe, por gjuha e tij u kthye për ne të gjithë. Sot, fjala e Camajt është sërish e lirë, pa zezomën e Ish- Sigurimit te Shtetit, që përmes baltosjes kërkon shfajësim nga kriminalizimi.
Kujtimi i Martin Camajt është një akt nderimi ndaj atyre që ruajtën dritën e gjuhës dhe mendimit shqiptar përtej mureve të izolimit dhe helmit .
Autoriteti dhe QKLL vazhdojnë të ndriçojnë rrugën e së vërtetës përmes dokumenteve dhe dëshmive që rikthejnë figurat e mohuara të kulturës shqiptare.

13 TETOR 2025 / "DRITËRO AGOLLI DHE UNIVERSALITETI NË VEPRËN E TIJ"

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit, organizoi aktivitetin përkujtimor kushtuar jetës dhe veprës së shkrimtarit Dritëro Agolli, me rastin e ditës së tij të lindjes, me temë: "Dritëro Agolli dhe universaliteti në veprën e tij".

Ky aktivitet u zhvillua për të kujtuar dhe reflektuar mbi trashëgiminë e një prej figurave më të ndritura të letrave shqipe, që i dha zë shpirtit të njeriut dhe kohës së tij. Në 13 tetor të vitit 1931 në Menkulas të Devollit, lindi gjeniu i letrave shqipe, Dritëro Agolli, një nga poetët, që i dha zë letërsisë shqipe, tek i cili dallohej aftësia për të shfaqur thjeshtësinë e vargut poetik me thellësinë emocionale e artistike. Poezia e Dritëro Agollit është e shkruar brenda Shqipërisë dhe realitetit kulturor e social shqiptar, por vargu i tij poetik prek tema universale, që i përjeton çdo njeri pavarësisht kulturës përkatëse apo kufijve gjeografikë. Dritëro Agolli në vargun e tij poetik trajton tema, që i përkasin përvojës njerëzore, të cilat përfshijnë çdo kulturë, vend, komb, ku mund të përmenden: a) tematika njerëzore dhe të përjetshme, si: dashuria, malli, vetmia, dhimbja, fitorja, humbja, frika; b) figurat universale, si: Njeriu, toka, nëna, babai, gruaja; c) tema filozofike, si: Jeta, vdekja, koha etj. Pra Dritëro Agolli në vargun e tij poetik tejkalon kufijtë kombëtarë, kohorë dhe kulturorë, duke trajtuar tema, ndjenja dhe përvoja, që janë të përbashkëta për gjithë njerëzimin.

15 TETOR 2025 / TAKIM ME SHKRIMTAREN FLUTURA AÇKA

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit në bashkëpunim me Bibliotekën "Musine Kokalari", në kuadër të muajit të letërsisë organizoi një takim mes lexuesve dhe autores Flutura Açka, ku u diskutua mbi librin e saj të fundit "Para se të iki", por edhe mbi krijimtarinë e saj në tërësi.

18 TETOR 2025 / NË NJË BISEDË ME PËRKTHYESIT, PRIMO SHLLAKU DHE KLODETA DIBRA

"Klasikët në përkthim" ishte tema e takimit të dytë që u mbajt më mjediset e librari "Albas", ku të ftuar ishin dy përkthyesit, Primo Shllaku dhe Klodeta Dibra, të cilët folën mbi punën e palodhur të përkthyesit, gjuhën shqipe, rëndësinë e ripërkthimit të klasikëve dhe nobelistëve, si dhe prirjen e lexuesit për të përzgjedhur për lexim tituj të përkthyer.

20 TETOR 2025 / NË NJË TAKIM ME SHKRIMTAREN E NJOHUR SERBE MAŠA SENIČIĆ

Në Arkivin Shtetëror të Filmit në Tiranë u zhvillua aktivitet i veçantë me pjesëmarrjen e Maša Seničić, një shkrimtare e njohur serbe, e cila po qëndron gjatë muajit tetor në Tiranë si rezidente letrare. Programi u organizua nga ILP, në bashkëpunim me KROKODIL si pjesë e projektit *Literature Actually*, i mbështetur nga British Council përmes nismës *Culture and Creativity for the Western Balkans.*

Ky diskutim i hapur eksploroi ndërthurjet mes letërsisë, filmit dhe praktikave bashkëkohore krijuese, duke reflektuar mbi mënyrën se si këto forma arti ndikojnë dhe formësojnë njëra-tjetrën në peizazhin kulturor të sotëm.

Aktiviteti u zhvillua pranë Arkivit Shtetëror të Filmit.
Culture and Creativity for the Western Balkans European Union in Albania EU u Srbiji



23 TETOR 2025 / NË PËRKUJTIM TË VEPRËS SË S. "FISHTA NË LETRAT SHQIPE" - NË GJIMNAZIN "IBRAHIM RUGOVA" TIRANË

Me rastin e Tetorit të librit, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, në bashkëpunim me gjimnazin "Ibrahim Rugova" Tiranë, organizoi aktivitetin "Fishta në letrat shqipe", më datë 23 tetor 2025, ora 11 a.m.

Ky event, u zhvillua, me rastin e 154 - vjetorit të lindjes së tij.

Në kujtim të veprës së tij madhore, drejtoresha e shkollës "Ibrahim Rugova", znj. Luljeta Prençi mbajti kumtesën: "Lahuta e Malcis', Iliada e letërsisë shqipe".

Dr.Jolanda Bibaj, mësuese e letërsisë dhe rrethit letrar, referoi mbi: "Satira e Fishtës - Gomari i Babatasit". Nxënësit e rrethit letrar, interpretuan fragmentet më të spikatura nga krijimtaria e Fishtës si: ''Lahuta e Malcis',''Atdheu", "Gjuha shqipe'',"Gomari i Babatasit".

Për 45 - vjet me rradhë shkrimtari Gjergj Fishta u përjashtua nga letrat shqipe.

Vepra e tij u hoq nga qarkullimi. Vlerat e tij letrare u mohuan. Nëpër tekstet letrare, emri i tij përmendej vetëm me konotacione negative.

Vepra e Fishtës nisi të botohej vetëm pas rënies së diktaturës.

''Nuk thuhet kot: rrufeja bie mbi lisat e gjatë! Si Fishta prej letërsisë shqipe, prej letërsisë kombëtare në vitet e socializmit.''- (Rexhep Qosja, ''Fishta dhe ne'', gazeta ''Drita'' 27 tetor 1991, fq 6).

Figura më e madhe dhe më e fuqishme e letërsisë shqiptare të gjysmës së parë të shekullit të njëzetë është ati françeskan Atë Gjergj Fishta (1871-1940), i cili më shumë se cilido shkrimtar tjetër i dha shprehje artistike shpirtit kërkues të Shtetit të ri sovran shqiptar.

''Me të drejtë i kanë thënë Fishtës Tireu i Shqipërisë se, sikurse ai me elegjitë e tij , ndezi zemrat e spartanëve për luftë, ashtu dhe epopeja e Lahutës, odet dhe elegjitë e Mrizit të Zanave e poezive të tjera, kanë mbjellë në zemër të djelmnisë s'onë, dashurinë e pamasë për truellin e të parëve dhe për gjuhën amtare''- (prof. Aleksandër Xhuvani: ''Fishta në gjykimin e bashkëkohësve'', gazeta ''Zëri i Rinisë'', 21gusht 1991, fq 3).

Në fushën e letrave Fishta lëvroi gjini të ndryshme si poezinë epike ashtu edhe atë lirike e satirike, dramën, publicistikën dhe përkthimin. Si ndër më përfaqësuesit të poetëve romantikë, shkroi vepra që zhvillojnë tema të poezisë gojore dhe të traditës, duke u mbështetur shumë mbi modelet stilistikore folklorike dhe duke përfshirë metrikën folklorike.

Fishta është shkrimtari i vlerësuar më skajshëm në historinë e letërsisë sonë.

Ajo që pranohet prej të gjithëve, prej himnizuesve dhe prej kundërshtarëve, është fakti se pa emrin dhe veprën e Fishtës, askush nuk mund ta kuptonte zhvillimin e poezisë shqipe, mendimin letrar dhe disa rrjedha kulturore të periudhës së Pavarësisë, po aq sa nuk mund të kuptohet letërsia e vjetër shqipe pa Bogdanin.

18 TETOR 2025 /TAKIM ME AUTORIN ODISE KOTE NË PËRURIMIN E LIBRIT TË TIJ

"Vetëdija ime mban meshë" është vëllimi më i ri poetik nga autori Odise Kote, botuar me përkujdesje nga shtëpia botuese "Toena".
Në promovimin e këtij vëllimi poetik, i cili u mbajt në mjediset e Qendrës "Sotir Kolea" ishin të pranishëm figura të njohura të kulturës, si: Aleksandër Çipa, Marash Mirashi, Agim Baçi, Irena Toçi, të cilët ndanë me të pranishmit, dashamirësit e autorit si dhe të rinjtë e gjimnazit "Andon Zako Çajupi" vlerësimet dhe gjykimet e tyre për vëllimin poetik.

24 TETOR 2025 / NË NJË BISEDË ME AUTOREN RAJMONDA BELLI GJENÇAJ

Me autoren Rajmonda Belli Gjençaj dhe nxënësit e shkollës "Kushtrimi i lirisë" në hapësirat e "Tirana Mooons" për librin dhe letërsinë që frymëzon brezat e së ardhmes dhe ndriçon mendjen e gjithsecilit prej nesh.

30 TETOR 2025 / TË DISKUTOJMË PËR LIBRIN: TAKIM ME AUTORIN ELVIN NURI NË NJË DISKUTIM PËR LIBRIN E TIJ ME POEZI "KAOS ZHERMINAL"

Në një atmosferë të ngrohtë letrare u promovua vëllimi me poezi, *"Kaos Zherminal"* i autorit Elvin Nuri, fitues i Çmimit të Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit për autorët e rinj. Ky botim shënon një zë të veçantë në poezinë bashkëkohore shqiptare, duke sjellë reflektime mbi jetesën urbane, vetminë dhe ritmet emocionale, veçanërisht të Tiranës së dekadës së fundit.
Poezitë e Nurit lexohen si fragmente të një ditari të heshtur qyteti, ku përzihen ndjesitë, vetmitë dhe ritmet që përbëjnë përditshmërinë e Tiranës. Përmes tyre, poeti arrin të japë një tablo intime të brezit të tij: një brez që lëkundet mes lodhjes politike, cinizmit të përditshëm dhe një dëshire të papërkufizuar për të jetuar me intensitet.

30 TETOR 2025 / BISEDË ME AUTORË TË RINJ - LIZA BROZI DHE ANTONIO ÇIKOLLARI

Autorët e rinj - Liza Brozi dhe Antonio Çikollari. Dy prej fituesve të Fondit të Krijimtarisë Letrare për të Rinj 2025, mbështetur nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, me veprat e tyre:
"Pesë vdekje" – Antonio Çikollari
"Vdekja e kukullës" – Liza Brozi